

Gjykata Komunale në MITROVICA/MITROVICË

P. Nr. 25/09 – KBr. 25/09

15 Maj 2009

NE EMËR TË POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË,

Me Gjyqtaren e EULEX Christine Lindemann-Proetel si gjyqtare me trup gjykues një anëtare,

Asistuar nga Zyrtarja Regjistruese Tara Khan,

Në lëndën penale kundër të akuzuarit **Daut RRAHMANI,**

Akuzuar me veprën penale të Plagosjes së Lehtë Trupore kryer në bashkëpunim, Neni 153 paragraf 1 pika 4 dhe paragraf 2, në lidhje me Nenin 23 të Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës ("KPPK"), dhe Dëmtimi i Pasurisë së Luajtshme e kryer në bashkëveprim , Neni 260 paragraf 2, në lidhje me Nenin 23 të KPPK, në shqyrtimin kryesor të shpejtuar të mbajtur në publik në datën 12 Maj 2009 dhe në 15 Maj 2009

Në prani të të akuzuarit, Avokati i tij Mbrojtës Xhelal Hasani, dhe të Prokurorit Publik të EULEX Jari Mikko Auvinen

Në 15 Maj 2009 shqiptuan si më poshtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari, Daut RRAHMANI, i biri Mehmet Rrahmani dhe Alie Muharremi, ID nr. 1172314755, lindur në 18 Gusht 1974, në Mitrovicë, Shqiptar i Kosovës, banor në Rrugën Tirana 06, "Bosnja e Vogël, Mitrovicë, Kosovë, i pamartuar, ka kryer shkollën fillore, aktualisht i pa punë, me status ekonomik mesatar, i pa dënuar më parë,

gjendet

FAJTOR

për arsye se

Në 4 Janar 2009 rreth orës 20:30-21:00, në afërsi të kryqëzimit të rrugëve Knjaz Milos dhe Oslobodjenja në Mitrovicë, Daut Rrahmani duke vepruar sëbashku me persona të panjohur, ndërsa i armatosur me shkopa beisbolli dhe/ose shkopinj druri, iu afruan veturës me targë KM-153-68 që i përkiste palës së dëmtuar Djordjevic Bata, i cili ishte sëbashku me Gusnic Perica.

Daut Rrahmani sëbashku me persona të panjohur, mbasi i kanë sharë personat në veturë, sulmuan Djordjevic Bata duke i shkaktuar disa dëmtime në kokën dhe trupin e tij, duke i shkaktuar dëmtime të lehta trupore, të cilat e paaftësuan përkohësisht shëndetin e tij.

Në të njëjtën kohë ata goditën veturën me shkopa beisbolli dhe/ose shkopa druri dhe e dëmtuan atë. Veprimet u motivuan nga paragjykimi për Serbët.

Kështu pra, kreu

Veprën penale të Plagosjes së Lehtë Trupore, në kundërshtim me Nenin 153 (1) (4) dhe 153 (2) në lidhje me Nenin 23 KPPK,

dhe
Veprën penale të Dëmtimit të Pasurisë së Luajtshme, në Kundërshtim me Nenin 260 (1)(2), në lidhje me Nenin 23 KPPK.

Në lidhje me veprën penale të Plagosjes së Lehtë Trupore jepet një dënim prej 5 muajsh burgim.

Për veprën penale të Dëmtimit të Pasurisë së Paluejtshme jepet një dënim prej 2 muajsh.

Kështu, i akuzuari Daut RRAHMANI është

DËNUAR

me një dënim të përmbledhur prej 6 (gjashtë) muaj burgim sipas Nenit 71 (1) dhe (2) KPPK.

Ky dënim nuk do të kryhet nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë veper penale tjetër për një periudhe prej **dy (2) vitesh** sipas Neneve 44 (1) (2) (3), 45 (1) KPPK.

Nw rast tw revokimit tw tw dwnimit me kusht, koha e paraburgimit nga **15 Janari 2009 deri 11 Shkurt 2009** pwrfsihet nw kwtw dwnim sipas Nenit 391 (1) pika 5 KPPPK.

SHPENZIMET

I akuzuari duhet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 102 (1) të KPPPK me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit. Një vendim i vecantë mbi shumën e shpenzimeve duhet të jepet nga gjykata kur këto të dhëna të përftohen suipas Nenit 100 (2) KPPPK.

ARSYETIMI

I. Autoriteti i Gjykatës

Në 16 Janar 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX ushtroi të drejtën e saj për të ngarkuar gjyqtarët e EULEX për lëndët që bien nën autoritetin shtesë të gjyqtarëve të EULEX (Nenet 3.4 të Ligjit mbi Juridiksionin, Zgjedhjen e Lëndës dhe Caktimin e Lëndës të Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-053). Autoriteti thelbësor dhe territorial i gjyqtarit individual në Gjykatën Komunale në Mitrovicë rrjedh nga Neni 21 paragraf 1 pika 1, Neni 22 paragraf 2 dhe Neni 27 paragraf 1 KPPPK.

II. Faktet e provuara

Gjykata është e bindur tej dyshimit të arsyetuar për faktet që vijojnë:

1. Në 4 Janar 2009 rreth orës 20:30-21:00, në afërsi të kryqëzimit të rrugëve ndërmjet Knjaz Milos dhe Oslobodjenja në Mitrovicë, një grup i armatosur me shkopa beisbolli dhe/ose shkopinj druri, iu afruan veturës me targë KM-153-68 që i përkiste Djordjevic Bata, i cili ishte sabashku me Gusnic Perica.

Mbasi i kanë sharë personat që gjendeshin në veturë, grupi sulmoi Djordjevic Bata duke i shkaktuar disa plagosje në trup dhe në kokë, duke shkaktuar plagosje të lehta trupore, të cilat e paaftësuan përkohësisht shëndetin e tij.

Në të njëjtën kohë ata e goditën veturën me shkopinj beisbolli dhe/ose shkopinj druri dhe e dëmtuan atë.

Kjo rrjedhë ngjarjesh është vërtetuar nga dëshmitë e të dëmtuarve që përputheshin te Djordjevic Bata dhe dëshmitarëve Gusnic Perica dhe Markovic Bojan.

Djordjevic Bata dëshmoi që kjo ngjarje ndodhi si është përshkruar më lart dhe shtoi më saktësisht që një grup prej 6-7 personash që mbanin shkopa druri dhe tuba iu afruan veturës, një person iu afrua dritares nga ana e shoferit. Sulmuesit e tërhoqën atë jashtë veturës dhe e shtrinë në tokë, dhe më pas e goditën atë në kokë dhe në trup me shkopinj. Ai vuajti plagosje të lehta në trup dhe në kokën e tij, dhe mori të qepura në dorën e tij. Xhami përpara dhe dy dritaret anësore të veturës së tij u thyen dhe gjithashtu dritat e mbrapme.

Gjykata e vlerëson këtë dëshmi të besueshme, vecanërisht sepse pala e dëmtuar nuk e fajëson të akuzuarin. Ai në mënyrë të qëndrueshme dëshmoi që ai nuk mund ta identifikonte ndonjërin prej sulmuesve. Edhe në sallën e gjyqit, kur mund të ishte shumë e lehtë të pretendonte që ai tashti e njohu të akuzuarin, pala e dëmtuar nguli këmbë në paaftësinë e tij për të thënë nëse i akuzuari ishte apo jo në mes të atyre që e sulmuan.

Për më tepër, deklarata e Djordjevic Bata është konfirmuar nga dëshmia e Gusnic Perica në të gjitha elementët thelbësorë. Mospërputhjet e vogla që sipas Gusnic Perica një grup prej 10 personash iu afruan veturës dhe këta persona mbanin shkopa beisbolli, nuk e cvleresojne besueshmërinë të asnjë prej dëshmitarëve. Në kontrast, mospërputhjet e vogla tregojnë që pala e dëmtuar dhe dëshmitari e Gusnic Perica nuk i kanë koordinuar deklaratat e tyre me njëri tjetrin. Është normale që detaje të tilla shihen dhe futen në kujtesë në mënyrë të ndryshme nga personat e involvuar. Gjykata, deri tani, nuk sheh ndonjë arsye të bëjë kërkime në lidhje me deklaratën e dhënë nga dëshmitari Gusnic Perica. A i e dha dëshminë e tij në një mënyrë të qetë dhe serioze pa dëshirë për hakmarrje.

Më tej, dëshmia e Oficerit të Policisë Markovic Bojan është mbështetëse e deklaratës së dhënë nga Djordjevic Bata dhe Gusnic Perica. Ai dëshmoi që ishte në detyrë duke patrulluar kur ai pa rreth 40 m larg në kryqëzimin e rrugëve Knjaza Milosa dhe Oslobodjenja rreth 10 persona që po qëndronin afër një veture Lada Samara, të paktën njëri prej tyre me shkop beisbolli ndërsa të tjerët mbanin shkopinj druri. Tre apo kater prej këtyre personave po godisnin dhe shkelmonin një person të shtrirë në tokë në afërsi të veturës, ndërsa të tjerët po i shkaktonin dëmtime veturës. Të gjithë personat e pranishëm po merrnin pjesë në veprime, ose duke rrahur viktimën ose duke i shkaktuar

dëmtime veturës. Në mënyrë të vecantë dëshmia e këtij dëshmitari është e besueshme, duke qenë se ai vetë nuk ka qenë i involvuar në incident por e ka vrojtuar atë si officer policie në detyrë, pra duke qenë në dijeni të nevojës që të jetë i vëmendshëm për të gjitha detajet e mundëshme në lidhje me ngjarjen.

2. Anëtarët e grupit me dijeni dhe me dëshirë vepruan sëbashku.

Kjo rrjedh nga rrjedha e ngjarjeve të provuara, në mënyrë të vecantë nga fakti që disa nga sulmuesit ishin të pajisur me shkopa beisbolli dhe/ose shkopa druri, përkatësisht. Më tej, grupi mbritti praktikisht në të njëjtën kohë në vendin e incidentit. Cdo pjesëmarrës mund të shihte se çfarë ishte duke ndodhur dhe mund të kishte ndërhyrë ose të paktën mund të ishte larguar nga vendi i ngjarjes, nëse ai apo ajo nuk ishte dakord me veprimet e grupit.

3. I Akuzuari Daut mori pjesë aktive në këto veprime.

Gjykata e konsideron këtë të provuar më tej dyshimit të arsyetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve Gusnic Perica dhe Markovic Bojan.

Gusnic Perica dëshmoi që ai e ka njohur të akuzuarin Daut Rrahmani si njërin prej sulmuesve. Ai nuk e dinte emrin e të akuzuarit në kohën e incidentit, por njohu fytyrën e tij sepse ata të dy sëbashku kishin banuar në të njëjtën zonë, në Bosnjen e Vogël në Mitrovicë, për rreth 10 vjet që në fillim viteve 90. Hera e fundit që ai e kishte parë të akuzuarin ishte vetëm disa muaj para incidentit. Ata asnjëherë nuk kanë pasur kontakte të afërta dhe asnjë mosmarëveshje me njëri tjetrin.

Dëshmia është e besueshme, meqenëse dëshmitari në mënyrë të bindshme shpjegoi përse ai mundi të njohte fytyrën e të akuzuarit, por nuk e dinte emrin e tij, kur ai u pyet për herë të parë. Dëshmitari nuk ka arsye të japë dëshmi të rreme kundër të akuzuarit. Ai vetë nuk ka interes të bëjë ndonjë dëm kundrejt të akuzuarit, dhe ai e njeh atë vetëm si pamje. Nuk mundet gjithashtu që marëdhënia e afërt me shkoun e tij Djordjevic Bata të jetë arsye për të dhënë dëshmi të rreme, meqenëse ky i fundit nuk e inkriminon të akuzuarin fare. Gjykata, më tej, është e bindur që dëshmitari nuk e ngatërroi të akuzuarin me dike tjetër, duke qenë se ai e kishte njohur atë për një kohë të gjatë dhe ai e kishte parë atë disa muaj para incidentit.

Fakti që dëshmitari e identifikoi të akuzuarin në fotografi, e cila iu tregua atij në stacionin e policisë jo në përputhje me procedurën e parashikuar nga Neni 255 KPPPK, nuk e bën deklaratën dëshmi të papranueshme. Dëshmia e marë në kundërshtim me dispozitat e

procedurës penale është e papranueshme vetëm kur në mënyrë të vecantë përshkruhet (Neni 153 Paragraf 1 KPPPK), i cili nuk është rast i lidhur me Nenin 255 KPPPK. Ajo as e nxjerr dëshminë të pavlefshme. Dëshmitari e ka njohur të akuzuarin para incidentit dhe ai e ka njohur dhe identifikuar atë në momentin e incidentit – ai vetëm nuk dinte emrin e tij në atë kohë. Ai, gjithashtu e njohu të akuzuarin në sallën e gjyqit si një person që e kishte njohur për një kohë të gjatë. Kjo është një situatë e ndryshme nga ajo që thotë procedura e parashikuar në Nenin 255 KPPPK, që do të thotë që dëshmitari do të identifikojë një të dyshuar të cilin ai nuk e njeh.

Dëshmitari Markovic Bojan dëshmoi që ai e njohu të akuzuarin Daut Rrahmani si personi që filloi i pari të fliste me shoferin dhe më pas sëbashku me të tjerët e tërhoqën shoferin jashtë veturës. Megjithatë, ai nuk ishte i sigurtë, nëse i akuzuari mori pjesë në goditjet dhe shkelmimin e shoferit. Ai e njohu të akuzuarin Daut Rrahmani sepse ai ishte i dyshuar në dy lëndë penale vjedhjeje të mëparshme dhe dëshmitari e kishte marrë atë në stacionin e policisë rreth dy vite më parë. Ai gjithashtu e kishte parë atë më vonë disa herë në zonën e Bosnjes së Vogël.

Kjo dëshmi është e besueshme së pari për arsye të përgjithshme të përmendura më lart (shih 1). Së dyti, shpjegimi përse ai mund ta njohu të akuzuarin ishte i bindshëm. Madje edhe mbrojtja i referohet arrestimit të mëparshëm dy vite më parë. Megjithatë, gjykata e përjashton mundësinë që dëshmitari mund të ketë inkriminuar të akuzuarin në mënyrë që të hakmerrej për shkëmbimin e fjalëve që ka ndodhur në atë kohë. Oficerët e policisë shumë shpesh sulmohen verbalisht nga personat e arrestuar si pasojë e situatës së jashtëzakonshme emocionale. Ideja që një officer policie mund të hakmerret për një ngjarje të tillë vetëm dy vjet më pas është më tepër për tu konsideruar e pabesueshme. Dëshmitari Markovic Bojan në mënyrë të dukshme ka demonstruar sjelljen e tij të pa paragjykuar, kur ai qartësoi që ai nuk ishte i sigurtë nëse vetë i akuzuari e shkelmoi apo/ose e goditi palën e dëmtuar.

Dukshëm, i akuzuari në mënyrë të qëndrueshme deklaroi që ai nuk ishte i pranishëm në kohën që incidenti ndodhi, por shkoi në qendrën shëndetsore në 04 Janar 2009 rreth orës 19:00 për të bërë një injeksion, sepse ai nuk ndjehej mirë. Sëbashku me motrat e tij Halise Balinca dhe Aferdita Rrahmani ai shkoi në shtëpi dhe më pas ai qëndroi në shtëpi. Ai vuan nga depresioni dhe shpesh mer injeksione të tilla që e bëjnë atë të ndihet i dobët.

Deklarata e të akuzuarit mbështetet nga dëshmitaret Halise Balinca dhe Aferdita Rrahmani. Te dyja sëbashku konfirmuan që kanë qenë me të akuzuarin në mbrëmjen e datës 4 Janar 2009. Mbasi ai mori injeksionin rreth orës 19:00, i akuzuari ka qëndruar në shtëpi dhe ka fjetur në dhomën e tij të gjumit në pjesën e mbetur të ditës.

Megjithatë, dëshmitë e tyre nuk mund të vlerësojnë deklaratat e kundërta të Gusnic Perica dhe Markovic Bojan, meqenëse Gjykata gjen që deklaratat dhe alibia e dëshmitareve nuk është e besueshme. Megjithatë Halise Balinca dhe Aferdita Rrahmani mund të kenë dëshirën të dëshmojnë në favour të vëllait të tyre, nuk është e argumentuar mirë që ato dhanë dëshmi të rreme në mënyrë të qëllimshme. Por sidoqoftë, nuk është e besueshme që dëshmitaret mund të kujtojnë që ajo që ato përshkruan ndodhi saktësisht në 4 Janar 2009, megjithatë të dyja sëbashku u përputhën në atë që asgjë e vecantë kishte ndodhur atë ditë dhe se ato kishin dëgjuar rreth incidentit vetëm kur i akuzuari u arrestua. Arrestimi i të akuzuarit ndodhi në 15 Janar 2009, 11 ditë më vonë. Lidhur me datën e kësaj ngjarjeje të jashtëzakonshme, e cila ka gjasa të mbahet mend në mënyrë korrekte, dëshmitarja Aferdita Rrahmani tha “duhej të ishte data 10”. Pra, mundësia që ato ngatërruan ngjarjet e ditëve të ndryshme është dukshëm e madhe.

Dy raportet mjeksore në lidhje me Daut Rrahmani, të cilat janë dorëzuar nga mbrojtja dhe janë lexuar në Gjykatë, nuk kanë lidhje me praninë e të akuzuarit në vendin dhe kohën e incidentit, meqenëse ato i referohen trajtimit mjeksor në Mars dhe Prill 2009.

4. Veprimet e grupit dhe në mënyrë të vecantë të të akuzuarit kanë qenë motivuar nga paragjykimi kundër Serbëve.

Ky motiv për veprimet e përshkruara më lart duhet të nxirret nga tërësia e rrethanave faktike të mëposhtme. I akuzuari nuk ka kapsur ndonjë mosmarëveshje para incidentit me palën e dëmtuar Djordjevic Bata, i cili nuk e kishte njohur të akuzuarin fare, apo dëshmitari Gusnic Perica, i cili e kishte njohur të akuzuarin vetëm nga pamja si një komshi disa vite më parë. Nuk ka pasur veprime provokuese nga ana e Djordjevic Bata dhe/ose Gusnic Perica të cilat do të mund të shkaktonin sulmin si një reagim i menjëhershëm, sepse ata sapo kishin mbratur në vendin e incidentit dhe ata ishin ende në veturë kur filloi sulmi (shih më lart nën 1.). Megjithatë, vetura, në të cilën ishin ulur Djordjevic Bata dhe Gusnic Perica, ishte e pajisur me targë me numër “KM-153-68”. Përgjithësisht është e njohur që numrat targës “KM-...” janë lëshuar nga autoritetet Serbe

dhe – në parim – të përorurra nga Serbët e Kosovës. Më tej, është e njohur që në kohën e incidentit, në ditët e para të këtij vitit, tensionimet ndëretnike në zonën e incidentit kanë qenë shumë të larta dhe disa incidente kanë ndodhur më parë. Kjo e fundit mbështet gjithashtu edhe nga dëshmitari Markovic Bojan.

Pra, motivi i vetëm i bindshëm për sulmin është ai i adoptuar dhe etnia aktuale Serbe e personave në veturë, që janë Djordjevic Bata dhe Gusnic Perica.

III. Cilësimi ligjor

Gjykata është në dijeni që vecanërisht në rajonin e Veriut të Mitrovicës ligji i aplikuar është nën diskutim. Gjykata thekson që Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe Kodi Penal i Kosovës (KPK) në lidhje me thelbin e tyre janë pothuajse identikë me versionet e tyre të mëparshëm, Kodi i Procedurës së Përkohshme Penale të Kosovës (KPPPK) dhe Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), në të cilat thelbi i cdo neni që gjykata aplikoi apo mund të ketë aplikuar në këtë lëndë, është plotësisht identik me procedurën ligjore të lartpërmendur.

Megjithatë Gjykata në këtë Aktgjykimt i referohet KPPPK dhe KPPK konsideroi dhe aplikoi thelbin e këtyre neneve relevante.

I akuzuari duke e ditur dhe me dëshirë veprroi sëbashku me keqbërësit e tjerë të panjohur në shkaktimin e dëmtimit trupor mbi palën e dëmtuar Djordjevic Bata duke e shkelmuar dhe goditur atë, duke përdorur objekte të aftë të shkaktonin plagosje trupore serioze, që ishin shkopa beisbolli dhe/ose shkopa druri. Kjo rezultoi në paaftësimin e përkohshëm të shëndetit të Djordjevic Bata, i cili vuajti plagosje të lehta në kokë dhe në trup dhe të qepura në dorën e tij. Duke kryer kështu veprën penale të Plagosjes së Lehtë Trupore, sipas nenit 153 paragrafi 1 pika 4 dhe paragrafi 2 KPPK në lidhje me Nenin 23 KPPK.

I akuzuari me dijeni dhe dëshirë veprroi sëbashku me keqbërës të tjerë të panjohur në dëmtimin e veturës Lada, me targa numër KM-153-68, që i përkiste Djordjevic Bata, të motivuar nga paragjykimi kundër etnicitetit Serb. Kështu pra ai ka kryer veprën penale të dëmtimit të Pasurisë së Luajtshme sipas Nenit 260 paragrafet 1 dhe 2 KPPK në lidhje me Nenin 23 KPPK.

IV. Përgjegjësia Penale

I akuzuari është penalisht përgjegjës për veprën penale të përshkruara në dispozitiv, Neni 11 paragrafi 1 KPPK në lidhje me Nenin 12 KPPK. Gjykata nuk ka dyshim që i akuzuari në kohën e kryerjes së këtyre akteve ishte plotësisht i aftë të kuptonte dhe kontrollonte veprimet e tij dhe të kuptonte që ai ishte duke kryer një vepër penale. Fakti që ai vuan nga depresioni, i cili konfirmohet nga dy deklaratat mjeksore të lexuara në gjykatë dhe deklaratat në një shkallë të besueshme të Halise Balinca dhe Aferdita Rrahmani, nuk e prek përgjegjësinë e tij penale në kohën e kryerjes së shkeljes penale. Vetë i akuzuari shpjegoi në përputhje me thëniet në lidhje me Halise Balinca dhe Aferdita Rrahmani, që gjendja e tij ndryshon dhe kur ai me të vërtetë nuk ndihet mirë, ai mer injeksione të cilat e bëjnë atë shumë të lodhur. Sodoqoftë, mënyra që i akuzuari veprroi në kryerjen e kryerjes së shkeljes penale tregon qartë që në atë kohë ai nuk ishte në gjendje që i nevojiteshin këto injeksione dhe as në gjendje mbasi i kishte marë ato.

V. Përcaktimi i Dënimit

Vepra Penale e Plagosjes së Lehtë Trupore është e dënueshme me burgim të paktën 15 ditë deri në 3 vite burgim, Neni 153 paragrafi 2 KPPK në lidhje me Nenin 38 paragrafi 1 KPPK.

Vepra penale e dëmtimit të Pasurisë së Luajtshme është e dënueshme me Gjobë ose me burgim deri në një vit, Neni 260 paragrafi 2 KPPK.

Në përcaktimin e dënimit, Gjykata konsideroi si rrethanë shpjeguese situatën e vështirë personale të të akzuarit, vecanërisht si pasojë e vuajtjes nga depresioni. Në favour të të akzuarit, Gjykata gjithashtu konsideroi që nuk ka dijeni për dënime të mëparshme.

Në lidhje me veprën penale të Plagosjes së Lehtë Trupore, Gjykata konsideroi në disfavor të të akzuarit që pala e dëmtuar Djordjevic Bata dhe dëshmitari Perica ishin në mëshirë të sulmuesve dhe vepra u motivua nga asgjë tjetër vecse paragjykim etnik. Nga ana tjetër, është llogaritur në favour të tij që plagët e Djordjevic Bata megjithse renditen si plagosje e lehtë trupore ishin të një shkalle të anës së ulët.

Në lidhje me veprën penale të Dëmtimit të Pasurisë së Paluejtshme, në mungesë të provës rreth sasisë së humbjes konkrete, dëmtimi i xhamit përpara, dy dritaret anësore dhe dritat e mbrapme të shtypura është llogaritur i ulët në favour të të akzuarit.

Në fund, Gjykata e konsideron të duhur dënimin pre 5 (pesë) muajsh për veprën penale të Plagosjes së Kehtë Trupore dhe 2 (dy) muaj burgim për veprën penale të Dëmtimit të

Pasurisë së Paluejtshme, dhe ka dhënë një dënim të përbashkët prej 6 (gjashtë) muajsh burgim.

Wshwt dhwnw njw dwnim me kusht, duke qenw se Gjkata nw lidhje me shqiptimin e dwnimit wshtw e mendimit qw dwnimi pa ekzekutim wshstw l mjaftueshwm pwr tw parandaluar tw akuzuarin tw kryejw vepra penale nw tw ardhmen dhe tw parandalojw persona tw tjerw nw kryerjen e veprave tw tilla tw ngjashme, Nenet 34, 42, 43 paragrafet 1 dhe 2, dhe 44 paragrafet 1-3 KPPK.

l akuzuari ka qenw nw paraburgim qw nw datwn 15 Janar 2009 deri nw 11 Shkurt 2009. Nw rast tw revokimit tw kwtij dwnimi me kusht nw kwtw periudhw kohore duhet tw pwrfsihet nw dwnim, Neni 391 paragrafi 1 pika5 KPPK.

VI. Shpenzimet

l akuzuari është gjetur fajtor. Pra, ai duhet të pagojë shpenzimet e procedurës penale , Neni 102 paragrafi 1 KPPK. Një vendim i vecantë mbi shumën e shpenzimeve duhet të jepet nga Gjykata kur të dhëna të tilla të përftohen, Neni 100 paragrafi 2 KPPK.

VII. Kompensimi

Pala e dëmtuar Djordjevic Bata është informuar sipas nenit 355 paragrafi 2 KPPK, që ai mund të dorëzojë një kërkesë për pasurinë brenda procedurave penale. Duke qenë që pala e dëmtuar nuk e ka dorëzuar një kërkesë të tillë, Gjykata nuk do vendoste në këtë çështje.

Pala e dëmtuar mbetet me të drejtë për të kërkuar kompensim në një procedurë ligjore.

Përgatitur në Anglisht, një gjuhë e autorizuar dhe e hartuar me shkrim në 29 Maj 2009.

Tara Khan
Zyrtare e Regjistrit

Christine Lindemann-Proetel
Gjyqtare e EULEX

Këshillë Ligjore: Një ankimim kundër këtij Aktgjykimi mund të dorëzohet në formë të shkruar nëpërmjet gjykatës Komunale në Mitrovica/Mitrovicë për në Gjykatën e Qarkut në Mitrovica/Mitrovicë **Brenda tetë (8) ditësh** nga data që kopja e aktgjykimit është shërbyer, Neni 473, paragrafi 3 KPPPK.